

KUJDES!

- Mos harroni të kodoni grupin (A ose B) në fletë-përgjigjen e provimit. **Fletë-përgjigjet me grupin e pakoduar nuk vlerësohen.**
- Çdo pyetje ka vetëm një përgjigje të saktë. Nëse një pyetjeje i jepni dy përgjigje atëherë ajo pyetje do të vlerësohet si e gabuar.
- Përgjigja do të kodohet me laps. Në të kundërt kompjuteri nuk do ta lexojë.
- Përgjigjen e pyetjes do ta kodoni vetëm brenda rrethit siç është vepruar në shembullin e poshtëshënuar

Saktë A B C D


Gabim A B C D

- Bëni kujdes për të mos dalë jashtë rrethit kur të kodoni përgjigjen.
- Mos bëni asnjë veprim mbi fletë përgjigjen e provimit si shkarravitje, rrudhosje etj.
- Mos iu përgjigjini pyetjeve për të cilat nuk jeni të sigurtë. **Kujdes! 3 përgjigje gabim fshijnë një të saktë.**
- Mos qëndroni shumë tek pyetjet që nuk zgjidhni dot, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për t'iu përgjigjur pyetjeve të tjera.
- Koha e provimit është **150 minuta**. Shfrytëzoni deri në fund kohën e provimit. Në qoftë se ju tepron kohë, bëjini dhe një kontroll testit.
- Përgjigjet e pyetjeve që ndodhen në këtë libërth, do të kodohen në fletë-përgjigje në pjesën ku shkruan “PERGJIGJET”.
- Në provim **ndalohet** mbajtja ose përdorimi i celularit dhe makinës llogaritëse.
- Rezultati i provimit bazohet vetëm në fletë-përgjigje.
- Libërthi i pyetjeve dorëzohet bashkë me fletë-përgjigjen dhe nuk kërkohet marrja e tij.

Suksese!

1.

Në figurë është paraqitur piramida e mbledhjes. Çdo numër është i barabartë me shumën e dy numrave poshtë. Gjeni vlerën e $a-b+c$?



- A) 10
- B) 11
- C) 12
- D) 13

2.

Shumëfishi më i vogël i përbashkët i numrave 12 dhe 15 është?

- A) 3
- B) 30
- C) 36
- D) 60

3.

Vlera e shprehjes $\sqrt{1^3 + 2^3 + 3^3}$ është:

- A) 4
- B) 6
- C) 36
- D) 50

4.

Shuma e tri kufizave të para të vargut $2n-1$ është:

- A) 5
- B) 9
- C) 12
- D) 15

5.

Vlera e shprehjes $2d^2 + 5$ kur $d = 5$ është:

- A) 15
- B) 25
- C) 55
- D) 105

6.

$$4.2 \times 0.01 =$$

- A) 420
- B) 42
- C) 0.42
- D) 0.042

7.

$$58 - 9.06 =$$

- A) 48.94
- B) 47.94
- C) 48.90
- D) 47.06

8.

Tili është Arkitekt. Ai paguhet 32 euro për orë, plus 35 euro për shërbimin në shtëpi.


Ai punoi në shtëpinë e Mondit.

Pagesa që i bëri Mondit është 147 euro. Sa zgjati puna e Tilit në shtëpinë e Mondit?

- A) 2 orë
- B) 2 orë dhe 30 min
- C) 3 orë
- D) 3 orë dhe 30 min

9.

Në figurë, PBC është një drejtëz. Drejtëza AQ është paralele me PQ. Cili nga pohimet e mëposhtme nuk është i saktë?



- A) $a+b+c=180$
- B) $c=y$
- C) $x=a+y$
- D) $b=y$

10.

Cili nga pohimet e mëposhtme nuk është i saktë?

- A) Këndi i shtrirë është 180° .
- B) Shuma e këndeve rreth një pike është 360° .
- C) Këndet përgjegjëse në drejtëza paralele të prera nga një e tretë nuk janë kongruente.
- D) Këndet ndërrues në drejtëza paralele të prera nga një e tretë janë kongruente.

11.

Cila nga të dhënat e mëposhtme është e dhënë diskrete:

- A) Gjatësia e një nxënësi
- B) Masa e një foshnje
- C) Numri i lojtarëve në një fushë futbollli
- D) Shpejtësia e një makine

12.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur lëndët e parapëlqyera të nxënësve të klasës së tetë. Pasi të plotësoni tabelën gjeni numrin e djemve që kanë zgjedhur shkencat natyrore.

	Matematikë	Shkenca natyrore	Anglisht	Lëndë tjetër	Gjithsej
Vajza	8	4		1	18
Djem	6		1	2	
Gjithsej					32

- A) 3
- B) 4
- C) 5
- D) 6

13.

Shkruani $\frac{3}{20}$ si përqindje.

- A) 3%
- B) 15%
- C) 20%
- D) 60%

14.

Kryeni veprimet $3\frac{1}{2} - 1\frac{3}{5}$.

- A) $1\frac{9}{10}$
- B) $2\frac{2}{5}$
- C) $2\frac{9}{10}$
- D) $\frac{9}{10}$

15.

Kryeni veprimet $\frac{3}{5}$ e 16 kg =

- A) 3 kg 200 g
- B) 7 kg 600 g
- C) 9 kg 300 g
- D) 9 kg 600 g

16.

Kryeni veprimet $24 \div \frac{6}{12}$

- A) 12
- B) 24
- C) 36
- D) 48

17.

Jam një katërkëndësh pa drejtëz simetrie.
Diagonalet e mia nuk e përgjysojnë njëra tjetrën dhe nuk formojnë kënd të drejtë.

Cila figurë jam?


- A) Katror
- B) Romb
- C) Paralelogram
- D) Trapez

18.

Kjo është skica e një sipërfaqeje trekëndore e vizatuar me shkallën 1:200.

Sa është gjatësia reale e hipotenuzës ?

- A) 2 m
- B) 20 m
- C) 200 m
- D) 2000 m



19.

Thjeshtoni shprehjen e mëposhtme.

$$11y^2 - 3y - 5y^2$$

- A) $3y$
- B) 3
- C) $6y^2 - 3y$
- D) $6y^2 + 3y$

20.

Danieli mendoi një numër.

Këtë numër e pjesëtoi me 3 dhe pastaj i zbriti 7.

Rezultati është 4.

Çfarë numri mendoi Danieli?

- A) 30
- B) 33
- C) 36
- D) 39

21.

40 nxënës bënë një provim.

Pikët e tyre janë paraqitur në tabelë.

Sa është klasa modale?

Piket	11-20	21-30	31-40	41-50
Denduria	8	16	9	7

- A) 16
- B) 11-20
- C) 21-30
- D) Nuk ka

22.

Numri i nxënësve në një shkollë, nga 540 që ishte një vit më parë, u ul në 486 këtë vit.

Sa përqind është ulur numri i nxënësve?

- A) 7%
- B) 8%
- C) 9%
- D) 10%

23.

Pika $(7; c)$ ndodhet në drejtëzën $y = 20 - 5x$.
Gjeni vlerën e c .

- A) -20
- B) -15
- C) 15
- D) 20

24.

Gjeni mesin e segmentit të ndërtuar nga pikat $A(-4; -3)$ dhe $B(2; 5)$.

- A) (1:1)
- B) (-1:1)
- C) (1:-1)
- D) (-1:-1)

25.

6 : 5 : 1 është trajta e thjeshtë e raportit:

- A) 18:15:1
- B) 18:25:3
- C) 18:15:3
- D) 12:15:5

26.

Pesë fletore kushtojnë 15 lekë. Gjeni sa kushtojnë 4 fletore.

- A) 10 lekë
- B) 12 lekë
- C) 15 lekë
- D) 20 lekë

27.

Një kompjuter nxjerr një numër njëshifror në mënyrë rastësore. Ai mund të jetë çdo numër nga 0 deri në 9.

Gjeni probabilitetin që ai të jetë shumfish i 3-shit.

- A) $1/3$
- B) $3/10$
- C) $2/10$
- D) $3/5$


28.

Gjeni syprinën e rrethit me diameter 18 cm. Përdorni $\pi=3$.

- A) 27 cm^2
- B) 36 cm^2
- C) 81 cm^2
- D) 243 cm^2

29.

Gjej syprinën e figurës së mëposhtme.




- A) 112 cm^2
- B) 24 cm^2
- C) 136 cm^2
- D) 243 cm^2

30.

Në grafikun rrethor janë paraqitur shitjet që ka pasur një dyqan për katër marka makinash gjatë muajit qershor. Gjatë këtij muaji u shitën 180 makina.

Sa makina të shitura ishin Toyota?

- A) 30
- B) 45
- C) 60
- D) 120



31.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

$$\begin{array}{l}
 \text{CEB} \\
 \text{KEB} \\
 \text{KAL} \\
 \text{LAB} \\
 \text{BAK}
 \end{array}
 \left. \vphantom{\begin{array}{l} \text{CEB} \\ \text{KEB} \\ \text{KAL} \\ \text{LAB} \\ \text{BAK} \end{array}} \right\}
 \begin{array}{r}
 937 \qquad 837 \qquad 567 \\
 \qquad 965 \qquad 769 \\
 \Rightarrow \mathbf{BAK} = ?
 \end{array}$$

- A) 965 B) 837
 C) 567 D) 769

32.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

$$\begin{array}{r}
 \text{abb} \\
 \text{abb} \\
 \text{abb} \\
 \hline
 \text{bc2}
 \end{array}
 \Rightarrow \mathbf{a + b + c = ?}$$

- A) 5 B) 6
 C) 7 D) 8

33.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

$$\begin{array}{r}
 \triangle \bullet \\
 \times \star \\
 \hline
 192
 \end{array}
 \quad
 \begin{array}{r}
 \triangle \bullet \\
 \times \blacksquare \\
 \hline
 448
 \end{array}
 \quad
 \begin{array}{r}
 \triangle \bullet \\
 \times \star \blacksquare \\
 \hline
 ?
 \end{array}$$

- A) 2274 B) 2285
 C) 2368 D) 2438

34.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

- I. $5 \bullet 4 = 81; 1$
 II. $4 \bullet 1 = 25; 27$
 III. $7 \bullet 5 = 144; 8$
 Iv. $5 \bullet 2 = ?; ?$

- A) 64;16 B) 54; 4
 C) 49; 27 D) 64; 64

35.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

I. $5 \square = 1025$

II. $7 \square = 1449$




III. $9 \square = 1881$

Iv. $4 \square = ?$

- A) 168 B) 618
C) 861 D) 816

36.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) $\frac{3}{8}$ B) $\frac{5}{8}$
C) $\frac{15}{8}$ D) 1

37.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

7 17 26 ? 41 47 52

- A) 34 B) 29
C) 30 D) 35

38.


Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) L B) LL
C) LLL D) LLLL

39.


Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) 38 B) 39
C) 40 D) 41

40.


Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) 9 B) 23
C) 35 D) 70

41.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) 4 B) 5
C) 6 D) 7

42.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

+	a	b	c
a			
b		c	

x	a	b	c
a	b	3·c	
b			

$\Rightarrow a + b = ?$

- A) 40 B) 42
C) 44 D) 46

43.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?


+	a	b	c	d
a	d	c		
b			d	
c				14

 $\Rightarrow a + b + c - d = ?$

- A) 2 B) 3
- C) 4 D) 5

44.


Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) 6 B) 7
- C) 8 D) 9

45.

Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?



- A)
- B)
- C)
- D)

46.


Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

2, 4, 7, 12, 14, 17, 22, ?

- A) 24 B) 25
- C) 26 D) 27

47.

Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) B) C) D)

48.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

- I. $a \otimes b = a^2 + 4 \cdot b - a \cdot b$
 II. $6 \otimes 9 = ?$

- A) 18 B) 20
 C) 22 D) 24


49.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

- I. II. III. A) B) C) D)

50.

Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) 60 B) 90
 C) 75 D) 120

51.

Kanë temë heroike, trajtojnë ngjarje historike, luftëra të vërteta dhe në fatin e heronjve luajnë rol dhe hyjnitë:

- A) Miti
- B) Përralla
- C) Legjenda
- D) Poema epike

52.

I përket letërsisë gojore:

- A) “Martesa me Orën-zonjë”
- B) “Kush e sollti Doruntinën”
- C) “Kthimi i Odisesë”
- D) “Kënga e Dhoqinës”

53.

“Idea se loja luftash e adoleshentëve u shndërrua në një betejë serioze, si parapërgatitje për luftën e jetës.”, jepet në veprën:

- A) “Një kryqëzim”
- B) “Djemtë e rrugës ‘Pal’”
- C) “Pyetja e fundit”
- D) “Kolombreja”

54.

Është cilësuar nga kritika si shkrimtar i *Brezit të humbur*:

- A) Ismail Kadare
- B) Mitrush Kuteli
- C) Petro Marko
- D) Musine Kokalari

55.

Rrëfimi bëhet në vetën e dytë dhe rrëfyesi është njëkohësisht dhe personazhi që dëgjon, në veprën:

- A) “Dritë që vjen nga humnera”
- B) “Lumi i madh”
- C) “Bota e Sofisë”
- D) “Siç më thotë nënua plakë”

56.

“Lumi qeshte e nënqeshte nën mustaqe”, kemi figurën letrare të:

- A) metonimisë
- B) metaforës
- C) epitetit
- D) krahasimit

57.

“Fjalë ose shprehje që përdoret në vend të një fjale a shprehjeje tjetër, të cilën nuk duam ose nuk duhet ta zëmë në gojë, fjalë a shprehje e butë a e zbutur”, është:

- A) Legjendë
- B) Mit
- C) Eufemizëm
- D) Novelë

58.

Trajton tema që lidhen me çështje të mëdha të ekzistencës së njeriut:

- A) “Bota e Sofisë”
- B) “Një dozë ‘poliane’”
- C) “Fliperi dhe fëmija”
- D) “Demiani”

59.

Në mitologjinë romake, Odiseja njihet me emrin:

- A) Homer
- B) Akil
- C) Uliks
- D) Itakë

60.

Pjesa “Lumi i madh” është shkruar nga:

- A) Petro Marko
- B) Ismail Kadare
- C) Mitrush Kuteli
- D) Ferenc Molnar

61.

Tema prej së cilës formohet drejtpërdrejt një fjalë e re është:

- A) tema fjalëformuese
- B) rrënja e fjalës
- C) tema e fjalës
- D) parashtesa dhe prapashtesa

62.

Dalloni fjalët e shkruara gabim:

- A) baras, rishtas, fytas
- B) barazi, rishtazi, haptazi
- C) standardet, digjte, humbte
- D) barasi, rishtasi, fytasi

63.

Ka përemër lidhor në fjalinë:

- A) Të vijë kush të dojë.
- B) A pyeti kush për mua?
- C) Kush mungonte sot?
- D) Ky ishte nxënësi i ri i klasës.

64.

Është shkruar saktë përemri pronor:

- A) atdheu jonë
- B) i, e time bije
- C) shoqes time
- D) atdheu ynë

65.

Është në formën joveprore, mënyra dëshirore, fjalia:

- A) Njeriu u mësuakësh dhe me këto kushte.
- B) Ai qenkësh emëruar diku tjetër këto kohë.
- C) Po ti u rritsh e u bëfsh sa malet!
- D) Do të ndihesha më mirë, po të kishe ardhur dhe ti.

66.

Në cilën prej alternativave kemi fjali me pjesë të nënrenditur ffilluese kryefjalore:

- A) E mira do të ishte që ju të punoni çdo ditë shumë fort.
- B) Asnjëherë nuk e kupton ku e ka gabimin.
- C) Fëmija që erdhi me vrap, u fut papritur në sallën ku rrinin të ftuarit.
- D) U afruan atje ku do të mbillnin pemën e parë.

67.

Ka ndajfolje në mënyrën sipërore:

- A) Vajza dukej e bukur e bukur sot.
- B) Ajo u vesh bukur dhe po priste miqtë.
- C) Sot i mbarova mësimet më shpejt se zakonisht.
- D) E veshi vajzën e vogël bukur bukur dhe u nis për në festë.

68.

Në cilën prej alternativave kemi vetëm lidhëza bashkërenditëse:

- A) se, që, në, nëse, nga
- B) ndaj, andaj, kurse, por, edhe
- C) porsì, sa, si, sesa, ndonëse
- D) e, dhe, që, ku, kur

69.**Ka kundrinor të drejtë në fjalinë:**

- A) Kjo gjë dihet nga të gjithë.
- B) Papritur e humba nga sytë, por e rigjeta sakaq.
- C) Jetoni për Shqipërinë dhe punoni për të.
- D) Atij i erdhi keq për nënën.

70.

“Ai veronte në një kasolle kashte pranë lumit.”, fjala e nënvizuar kryen funksionin si:

- A) rrethanor vendi
- B) përcaktor me përshtatje
- C) përcaktor me bashkim
- D) përcaktor me drejtim